

VENDIM
Nr. 131, datë 2.5.1997

Gjykata e rrethit Kurbin më datën 2.5.1997 shqyrtoi në seancë gjyqësore çështjen civile me nr.98/1321 që i përket:

Kërkuesi: Luigj Tarja, i biri i ndues dhe i Florintës, lindur në fshatin Gorre të rrethit Kurbin dhe banues në lagjen nr.4, pallati 101 të qytetit Laç, me arsim të lartë, i martuar. Të interesuar:

1.bashkia Laç

2.Prokuroria e rrethit Kurbin.

Me objekt: Shpalljen të vdekur të gruas së tij, Angje Fran Tarja dhe vajzës Xhilterta Luigj Tarja, në bazë të nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet e administroi provat vëren:

Nga hetimi i çështjes doli se më datë 13.1.1994 bashkëshortja e kërkuesit e quajtur angje dhe e bija Xhilterta janë nisur nga Vlora me skaf, për të shkuar në Itali tek motra e saj. Në udhëtim skafi me 16 persona pësoi defekt në motorët dhe me gjithë përpjekjet e skafistëve defekti nuk u riparua dot. Në një det me forcë 5 ballë skafi u mbyt. Nga 26 persona, 11 janë mbytur. Sipas informacionit të ambasadës së Shqipërisë në Romë me nr.1456, datë 20.10.1994 dhe vërtetimit të datës 20.10.1994 të Ministrisë së Punëve të jashtme del se ndër personat e mbytur janë edhe Angje Tarja dhe Xhilterta Tarja.

Përveç administrimit të këtyre provave shkresore, gjykata pyeti edhe dëshmitarë okularë të ngjarjes. Kështu, dëshmitari Ymer Gogolli dhe Angjelin Gjoni, të cilët kanë qenë udhëtarë në skafin e mbytur, sjellin prova bindëse se Angje dhe Xhilterta Tarja janë mbytur .

Me provat e mësipërme gjykata krijon bindje të plotë se Angje e Xhilterta Tarja, nënë e bijë, janë mbytur më datë 13.10.1994 në kanalin e Otrantos gjatë udhëtimit me skaf pët në Itali.

Në këto rrethana, kërkesa duhet të pranohet duke i shpallur ato si të vdekura.

Për këto arsye, në bazë të nenit 380 të Kodit të procedurës Civile, gjykata vendosi:

Të shpallë si të vdekur më datën 13.10.1994: Angje Tarja, e bija e Franit dhe Lezes, lindur më 25.8.1958, banuese në lagjen nr.4 të qytetit Laç dhe Xhilterta Tarja, e bija e Luigjit dhe e Angjes, lindur më 18.4.1988, banuese në lagjen nr.4 Laç.

Shkurtimi i këtij vendimi të botohet në Fletoren Zyrtare.

Pasi të zbatohen kërkesat e nenit 381 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi t'i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile të qytetit Laç.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve.

U shpall në laç më datën 2.5.1997.

Nr.i vendimit; 131

GJYQTARI
Besnik Qira